



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANE

NR.RREGJ.THEM. 9166

NR.VENDIMI 3284

V E N D I M
“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE, E PERBERE NGA:

MARINELA OSMANI – GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Valbona Maja**, sot me date 05.04.2012, perfundoi ne seance gjyqesore me dyer te hapura, çeshtjen civile Nr.9166, qe i perket:

KERKUES:

Bledar Meniku, i biri i Dilaver dhe i Bebeke, i datelindjes 12.12.1976, lindur dhe banues ne Tirane, Adresa: Rruga “Mine Peza”, Pallati 250/1, ap.14.

OBJEKTI:

Çelja e deshmise se trashegimise per te ndjerin Dilaver Meniku si dhe percaktimi i pjeseve takuese ne trashegim.

BAZA LIGJORE:

Nenet 348 e vijues te Kodit Civil.

Gjykata, ne perfundim te hetimit gjyqesor, pasi degjoi:


Palen kerkuese Bledar Meniku, i cili kerkoi leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per te ndjerin, Dilaver Meniku;

- pasi ia nenshtroi hetimit gjyqesor e çmoi provat e paraqitura dhe
- pasi shqyrtoi çeshtjen ne teresi;

V E R E N

Gjykata konstaton se ceshtja civile ben pjese ne juridiksionin gjyqesor dhe ne kompetencen lendore te saj, bazuar ne nenin 36 dhe nenin 41 te Kodit te Procedures Civile. Kerkuesi Bledar Meniku ka kerkuar leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per te ndjerin, babain e tij Dilaver Meniku.

Nga çertifikata e vdekjes Nr.0005300064, date 16.02.2012., rezulton e provuar se i ndjeri Dilaver Meniku ka vdekur ne Tirane me date 23.01.2012. Gjate shqyrtimit te



kesaj kerkese, Gjykata ka parasysh nenin 318 te Kodit Civil, nen ne te cilin eshte parashikuar se trashegimia çelet ne kohen kur vdes trashegimlensesi dhe ne vendin ku ai ka patur banimin e tij te fundit. Kjo trashegimi rregullohet sipas ligjit te kohes kur eshte çelur. Duke u bazuar nga sa me siper, provohet se i ndjeri Dilaver Meniku ka patur banimin e tij te fundit ne Tirane dhe ka vdekur perkatesisht me daten 23.01.2012. Ne keto kushte gjen zbatim Kodi i Ri Civil, i cili ka hyre ne fuqi me date 01.11.1994, qe eshte ligji i kohes kur eshte çelur trashegimia. Po keshtu, gjate hetimit gjyqesor, ne baze te provave te shqyrtuara nga Gjykata, nuk del se trashegimlensesi, i ndjeri te kete disponuar me testament pasurine e tij. Si rrjedhim, ne baze te nenit 317 te Kodit Civil, kur trashegimlensesi nuk ka bere testament zbatohet trashegimia ligjore. Ne keto kushte per te ndjerin Dilaver Meniku do te çelet trashegimia ligjore.

Ne baze te nenit 348 te Kodit Civil parashikohet se: ***“Cilesia si trashegimtar dhe pjeset takuese caktohen me deshmine e trashegimise, te leshuar nga Gjykata, sipas rregullave te percaktuara ne Kodin e Procedures Civile”.***


Nga teresia e provave te shqyrtuara nga Gjykata dhe nga deklarimet pales kerkuese ne séance gjyqesore, rezulton se trashegimlensesi Dilaver Meniku ka lene gjalle pas vdekjes se tij bashkeshorten dhe dy femijet e tyre.

Bazuar ne nenin 361 te Kodit Civil, percaktohet se si trashegimtare te rradhes se pare thirren femijet dhe bashkeshorti, i afte ose i paaftë per pune, duke trashëguar secili ne pjese te barabarta. Duke u mbështetur dhe ne tre dispozitat ligjore te Kodit Civil, si ne nenin 330 te Kodit Civil, sipas te cilit trashegimia fitohet me vdekjen e trashegimlensetit, ne nenin 318 te Kodit Civil, trashegimia çelet ne kohen kur vdes trashegimlensesi dhe ne nenin 320, po te Kodit Civil, i cili parashikon se ka zotesi per te trashëguar personi qe ne kohen e çeljes se trashëgimise eshte gjalle, Gjykata arrin ne perfundimin se bashkeshortja Bebek Meniku dhe femijet Linda Meniku dhe Bledar Meniku jane te vetmit trashëgimtare ligjore te rradhes se pare te trashëgimlensetit se tyre Dilaver Meniku.

Gjithashtu, gjate hetimit gjyqesor u provua se trashëgimlensesi Dilaver Meniku nuk ka lene trashëgimtare te tjere ligjore, trashëgimtarete e tij ligjore nuk jane bere te padenje per te trashëguar per asnje nga shkaqet e parashikuar nga neni 322 i Kodit Civil, nuk kane hequr dore nga trashëgimia ne asnje nga format e parashikuara nga neni 333 i Kodit Civil dhe se trashëgimlensesi nuk ka perjashtuar asnje nga trashëgimia ligjore, sipas nenit 378 te Kodit Civil.

Kerkesa behet per efekt te kalimit te pasurise nga emri i trashëgimlensesve ne favor te trashëgimtareve.





PER KETO ARSYE

Gjykata, mbeshtetur ne nenet 318, 348 dhe 361 te Kodit Civil, 127 dhe 306-310 te Kodit te Procedures Civile;

V E N D O S I


1. Pranimin e kerkeses se kerkuesit Bledar Meniku.
2. Leshimin e deshmise se trashegimise ligjore per trashegimlensesin, te ndjerin Dilaver Meniku.
3. Caktimin si trashegimtare ligjore te rradhes se pare te trashegimlensesit, te te ndjerit Dilaver Meniku:
 1. Bebeke Meniku (bashkeshortja)
 2. Linda Meniku (e bija)
 3. Bledar Meniku (i biri)te cilet thirren ne trashegim dhe trashegojne ne pjese te barabarta pasurine trashegimore te trashegimlensesit te tyre me nga 1/3 pjese secili.
4. Ne te njejtat raporte trashegimtarete pergjigjen edhe per detyrimet qe rendojne mbi pasurine trashegimore.
5. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te kerkuesit Bledar Meniku.
6. Kunder vendimit mund te behet ankim brenda 15 diteve nga dita e neserme e shpalljes se vendimit, ne Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall sot ne Tirane, me date 05.04.2012

**SEKRETARE
VALBONA MAJA**



**GJYQTARE
MARINELA OSMANI**



Shpenzime gjyqesore

Takse rregjistrimi	800 leke
Shpenzime kancelarike	200 leke

Totali 1000 leke


Sekretare: Valbona Maja

**VERTETOHET NJESIA
ME ORIGJINALIN
K / SEKRETARE
MIMOZA Tafa**


Vendimi mori forme te prete pasi
nuk u ankimua me dt 20 09 2012
Tirane me dt 23 09 2012

K / SEKRETARE

Mimoza CENAJ (LULAJ)



**KANCELAR
Rudin BAQLI**



1/8 - cosellou
04-03-2024

